Kronikë

Vlorë/ Mbanin në banesë armë zjarri e municion luftarak, babë e bir në pranga! 49-vjeçari me precedent të mëparshëm kriminal (EMRAT)

Bledar Kristo dhe Kreshnik Kristo janë arrestuar në flagrancë. Në shtëpinë e tyre janë gjetur dhe sekuestruar armë zjarri e municion luftarak.

Redaksia
13 Shtator, 12:59 | **Përditesimi: 13 Shtator, 13:05**

Share

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Babë e bir kanë rënë në pranga të Policisë së Vlorës të akuzuar për veprën penale të armëmbajtjes pa leje.

Bledar Kristo dhe Kreshnik Kristo (babë e bir), kishin fshehur në banesën e tyre në fshatin Mifol, 1 armë zjarri automatike me fishek në fole gati për qitje, 1 krehër me municion, rreth 200 gëzhoja dhe 1 armë të ftohtë (thikë).

Sakaq, Bledar Kristo 49 vjeç, rezulton me recedent të mëparshëm kriminal po për të njëjtën vepër penale, atë të armëmbajtjes pa leje.

LEXO EDHE:
Himarë/ Ndërtoi shtëpi druri pa leje dhe vendosi 4 kontenierë në Vuno, arrestohet 45-vjeçari

"Vlorë/Finalizohet me sukses nga Komisariati i Policisë Vlorë, operacioni policor i koduar "Duo", goditet një rast armëmbajtjeje pa leje.

Arrestohen në flagrancë babë e bir që posedonin armë zjarri dhe municion në banesë.

Sekuestrohen 1 armë zjarri automatike me fishek në fole gati për qitje, rreth 200 gëzhoja municioni dhe 1 armë e ftohtë.

Në kuadër të punës së pandërprerë për evidentimin dhe goditjen e rasteve të armëmbajtjes pa leje, si dhe për të parandaluar ngjarje të rënda kriminale që mund të ndodhnin nga përdorimi i tyre, shërbimet e Komisariatit të Policisë Vlorë, bazuar në informacionet e siguruara nga inteligjenca informative, organizuan dhe finalizuan me sukses operacionin policor të koduar "Duo".

Si rezultat i këtij operacioni, u arrestuan në flagrancë shtetasit:

•B. K., 49 vjeç, me precedent penal të mëparshëm për armëmbajtje pa leje;

** K. K., 21 vjeç, djali i tij, banues të dy në fshatin Mifol.*

Gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e tyre, në fshatin Mifol, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale 1 armë zjarri automatike me fishek në fole gati për qitje, 1 krehër me municion, rreth 200 gëzhoja dhe 1 armë të ftohtë (thikë).

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, për veprime të mëtejshme", njofton policia.

SI.E./I.M/Shqiptarja.com

TAG: armëmbajtje pa leje | kreshnik kristo | bledar kristo | Vlore

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Sa të sigurt ndiheni nga mashtrimet online?
14 Shtator, 14:32

Shumë | Pak | Aspak

Lajme të tjera

Vlorë/ Kremtohet 82-vjetori i Epopesë së Drashovicës, ndërim për heroizmin dhe sakrificën
Armand Xhelili
14 Shtator, 11:26

Deputeti Vullnet Sinaj: Dorëheqja e Ermal Dredhës nga Bashkia Vlorë, akt qytetarie! Qeveria Rama 4 nga më të mirat, me përgjegjësi në rrugën drejt BE-së
Armand Xhelili
14 Shtator, 10:11

Rritet turizmi kulturor në Vlorë, 42% më shumë vizitorë në sitet arkeologjike se një vit më parë
Armand Xhelili
14 Shtator, 08:11

'Të rihapen hetimet për Konomin', kërkesa e familjarëve të gjyqtarit që u ekzekutua me eksploziv në Vlorë
12 Shtator, 20:26

Ndeshja kundër Tiranës në kryeqytet, Carlos Garcia: Flamurtari shkon për të fituar
12 Shtator, 12:11

Dorëheqje, emërime e arrestime/ 6 bashkitë që shkojnë drejt zgjedhjeve të parakohshme
11 Shtator, 17:51

Pasi dha dorëheqjen nga Bashkia Vlorë, Ermal Dredha shkon në Asamblenë e PS: Socialist kam lindur dhe kështu do jem
11 Shtator, 10:52

Lejoi të kalonin kufirin dy të kërkuar për drogë, AMP ndalon policin e kufirit në Qafë-Botë
11 Shtator, 10:04

Dha dorëheqjen si kryebashkiak i Vlorës, Dredha mesazh qytetarëve dhe Ramës: Akt reflektimi e përgjegjësie! E rëndësishme të largohesh me dinjitet
11 Shtator, 07:47

Rikthehen reshjet e dendura të shiut! Përmbytje në Vlorë dhe Lezhë, problematike situata edhe në Durrës (VIDEO)
11 Shtator, 07:28

Dorëhiqet kryebashkiaku i Vlorës, Ermal Dredha! Ja kërkoi Rama?
Armand Xhelili
10 Shtator, 21:03

Korçë/ Në kërkim ndërkombëtar për mashtrim, arrestohet 32-vjeçari në Qafë Thanë
10 Shtator, 12:51

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje